



RAPORT MONITORIMI
FINANCAT & EKONOMIA
Maj-Korrik 2020



AUTOR
ANILA SALIANJI


QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom Around the World




Ekonomia e Shqipërisë nën efektin e pandemisë




Ekonomia e brishtë e Shqipërisë, në një periudhë shumë të shkurtër kohore pësoi dy goditje njëpasnjëshme, fillimisht tërmeti shkatërrimtar i datës 26 nëntor 2019 dhe më pas pandemia globale Covid-19, efektet e të cilave padyshim do të ndjehen gjatë. Izolimi i detyruar dhe paralizimi i aktivitetit ekonomik detyroi qeverinë të marrë një sërë masash për përbalimin e situatës. Brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore, buxheti i shtetit u rishikua 3 herë dhe pritet një reduktim në masën 63.1 miliardë lekë i të ardhurave buxhetore në krahasim me buxhetin fillestar të vitit 2020.

Gjatë fjalës së mbajtur në Kuvend në seancën e datës 29 Korrik teksa prezantonte ndryshimet në buxhet, ministria Anila Denaj u shpreh se parashikohet një rritje reale negative prej - 4.3% , ndërsa organizatat ndërkombëtare si **Banka Botërore, parashikojnë një tkurrje nga 5 deri në 6.9% të ekonomisë, e cila llogaritet më e larta në rajon**, për shkak të varësisë nga turizmi dhe modelit ekonomik të bazuar te bizneset e vogla, tregëtia dhe shërbimet¹.

Gjithashtu në **rishikimin e fundit të buxhetit** parashikohet që tkurrja e fortë e investimeve private të kompensohet nga një rritje e investimeve publike dhe konkretisht me një **ritje prej 30.16 miliardë lekë të shpenzimeve buxhetore** të cilat do të jenë kryesisht investime në infrastrukturë që këtë vit janë parashikuar 16% më të larta se vitin e kaluar.



Një tjetër **masë e ndërmarrë** nga qeveria ishte rishikimi i ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku **u hoq tatimi mbi fitimin e bizneseve me xhiro deri në 14 milionë lekë** deri në vitin 2029. Po ashtu **ndryshoi edhe pragu i TVSH, i cili do të jetë 10 milionë lekë nga 2 milionë që ishte më herët**. Në të njëjtën linjë me politiken fiskale po ecën edhe Banka Qëndrore. Nga ana e saj u ndoq menjëherë një politikë monetare lehtësuese. Më datë 25 mars 2020 **u ul norma bazë e interesit nga 1% në 0.5%**. Nëpërmjet kësaj politike synohet furnizimi i tregut me likuiditet sepse ulet çmimi i parasë dhe synohet të nxiten investimet dhe konsumi.



¹Western Balkans Regular Economic Report: Spring 2020

<https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>



Ndihmat dhe paketat financiare të miratuara nga qeveria

Në datë 27 Mars, thuajse dy javë pas shfaqes së rastit të parë me Covid në territorin e Republikës së Shqipërisë, qeveria miratoi **paketën e parë financiare** anti Covid (VKM nr.254) e cila përfshinte një pagesë prej 26.000 lekë për tre muaj rresht për të punësuarit në subjektet me të ardhura deri në 14 milionë lekë të cilave i'u ishte pezulluar aktiviteti ekonomik si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia. Sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga kjo paketë **kanë përfituar 65.078 persona me një efekt financiar 5 miliardë lekë.**

1
PAKETA

Ndërkohë që situata me pandeminë sa vinte dhe po rëndohej, qeveria në datë 16 prill me VKM nr. 305 miratoi **paketën e dytë financiare** e cila përfshinte një pagesë të vetme prej 40.000 lekësh. Në daljen publike për prezantimin e kësaj pakete, Kryeministri deklaroi se do të jenë përfitues 177.000 qytetarë, nga të cilët 10 mijë të punësuar në sektorin e turizmit, 66 mijë të larguar nga puna në biznesin e madh dhe 100.000 të punësuar në biznesin e vogël. Nga të dhënat e zyrtare të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë **rezulton se nga kjo paketë kanë përfituar 167.206 punonjës.**

2
PAKETA

Nga të dyja këto paketa të ndihmës financiare u përjashtuan profesionistët e lira, të cilët kontribuojnë jo pak në buxhetin e shtetit. Prej vitit 2013 ato janë futur në skemën e TVSH-së dhe duke qënë se ofrojnë shërbime dhe kanë shumë pak TVSH të zbritshme, janë të detyruar të paguajnë gjithë barrën e TVSH-së vetë. Por pavarësisht kontributit të tyre, ata u lanë totalisht në harresë nga qeveria duke mos marrë asnjë lloj mbështetje financiare.


Edhe **biznesi i madh** përfitoi mbështetje nëpërmjet një skeme të veçantë financimi të quajtur **Fondi i Garancisë Sovrane**, ndonëse në kulmin e pandemisë, Kryeministri Rama në një dalje publike në datën 10 prill do të shprehej për biznesin e madh se *“Kjo është një luftë, nuk jemi në situatën që të suleni në arkën e shtetit dhe të merrni fitimin e munguar. Ju do të humbni nga lufta, por humbja juaj është e fundit që ne do të llogarisim. Shisni jahtet, vilën e tretë*

**Fondi i
Garancisë
Sovrane**

ose të katërt që keni dhe paguani faturat dhe punonjësit". Pavarësisht këtyre deklarimeve, Këshilli i Ministrave miratoi instrumentin e parë të garancisë sovrane, me një vlerë fillestare prej 11 miliardë lekësh , për t'u ofruar bizneseve në vështirësi kredi me zero interes. Në marrëveshje me bankat e nivelit të dytë, qeveria mori përsipër që të garantonte 100% kreditë e këtij instrumenti dhe të subvenciononte plotësisht intereset e huave. Pra kjo nënkupton që shteti është përgjegjës për bizneset huamarrëse, në rast se këto të fundit nuk arrijnë t'i paguajnë detyrimet në kohë dhe në masën e duhur. Po ashtu në datë 13 maj, u miratua një linjë e dytë e garancisë sovrane, me një vlerë 15 miliardë lekë ku qevria mori përsipër të mbulonte vetëm 60% të principalit të kredisë.

Sipas një raporti të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, **nga fondi i parë i garancisë sovrane kanë përfituar 548 biznese me një vlerë totale prej afërsisht 6.5 miliardë lekë.** Ndërsa nga **fondi i dytë i garancisë kanë përfituar 119 biznese me një vlerë afërsisht 3.1 miliardë lekë,** nga 15 miliardë lekë që ishin vënë në dispozicion me anë të këtij instrumenti dhe afati për aplikim u shty deri në fund të muajit shtator.

Fondi i
Garancisë
Sovrane





Cilët janë përfituesit e Fondit të Garancisë Sovrane?



Ekipi i Qendresës Qytetare i dërgoi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë një kërkesë për informacion në datën 18 korrik lidhur me listën e bizneseve që kanë përfituar kredi të garantuara nga shteti me zero interes, por nuk morëm një përgjigje nga ana e ministrisë.

Por nga të dhënat e siguruar nga portali investigativ BIRN rezultojnë se gati **gjysma e fondit të miratuar shkoi për llogari të 10 kompanive të mëdha**, njëkohësisht përfituese të koncesioneve. Megjithëse këto kompani kanë përfituar pothuajse gjysmën e fondit të miratuar rezultojnë se nevojat e tyre për likuiditet kanë qënë të ulëta pasi këto 10 kompani së bashku deri në fund të muajit maj kishin tërhequr nga llogaritë vetëm 24% të shumës totale të përfituar.²



Megjithëse pritjet që përfituesit kryesorë të ish-in bizneset e prekura më shumë nga pandemia të tilla si sektori i turizmit apo fasoneria, në realitet përfituesi kryesor nga programi i garancisë sovrane në kushtet e një krize shëndetësore rezultojnë të jetë konglomerati më i madh i shërbimeve spitalore private në Shqipëri, Spitali Amerikan. Ky spital ka arritur të sigurojë dy linja kredie me rreth 547 milionë lekë gjithsej, nga të cilat deri në fillim të muajit qershor janë tërhequr 79.4 milionë lekë. Ajo çka bën përshtypje nga kjo situatë është fakti që shërbimet spitalore kanë vijuar të ofrohen edhe gjatë periudhës së pandemisë, madje me një fluks më të lartë pasi shërbimi spitalor shtetëror gjatë kësaj periudhe mbulonte vetëm urgjencat dhe rastet Covid, duke pezulluar kontrollet e planifikuara mjekësore.

Vendin e dytë ndër kompanitë përfituese e zë Albchrome, kompania më e madhe në sektorin e nxjerrjes dhe përpunimit të kromit në Shqipëri, e cila po ashtu zotëron edhe një kontratë koncesionare me qeverinë shqiptare. Kjo kompani ka përfituar dy linja kredie me një vlerë totale prej 410 milionë lekësh, nga të cilat janë tërhequr vetëm 62.2 milionë. Por Albchrome nuk është kompania e vetme pjesë e Balfin Group e cila ka përfituar hua të garantuara nga shteti. Përfitues janë edhe Neptun, Fashion Group Albania dhe Kid Zone, të cilat e çojnë në total 482.5 milionë lekë përfitimin nga skema e garancisë sovrane të Grupit Balfin.

² Burimi: Reporter.al “Koncesionarët e qeverisë, përfituesit e mëdhenj të fondit të garancisë sovrane”
<https://www.reporter.al/koncesionaret-e-qeverise-perfituesit-e-medhenj-te-fondit-te-garancise-sovrane/>



Një tjetër nga përfituesit e mëdhenj nga ky fond është Kastrati Group, nga bizneset më të mëdha në fushën e naftës i cili është edhe përfitues i 3 koncensionve në qeverinë aktuale. Ky sipërmarrës ka përfituar rreth 267.5 milionë lekë kredi me interes zero përmes tre kompanive të tij, Kastrati, Auto Star Albania dhe Continental Group. Për më tepër kjo kompani mori edhe subvencionim nga shteti shqiptar për fitimin e munguar si pasojë e kufizimit të qarkullimit, duke përfituar subvencion nga kontrata e koncensionit për mirëmbajtjen e rrugës së Kombit mbi 367 milionë lekë, pasi si pasojë e izolimit, qarkullimi i makinave në atë aks ishte i ulët.

Po ashtu përfitues të mëdhenj të kredisë me zero interes janë koncensionari i nxjerrjes së naftës Bankers Petroleum, koncensionari i rrugës së Arbrit "Gjoka Konstruksion", kompania fituese e koncensionit të rrugës Orikum - Dukat, "Gjikuria", madje edhe 3 kompanitë e financuara nga buxheti i shtetit për ndërtimin e incenatarorëve, megjithëse mbetet e paqartë se si ka ndikuar pandemia në aktivitetin e këtyre kompanve.

Po ashtu sektori mediatik dhe sektori i edukimit privat është bërë pjesë e instrumentit të garancisë sovrane. **Gjashtë shkolla dhe universitete private kanë përfituar kredi me zero interes me një vlerë totale prej 163.2 milionë lekë**, ndërkohë që universitetet publike nuk morën asnjë mbështetje shtesë dhe pavarësisht kërkesave të përsëritura të studentëve drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë, ata u detyruan të paguajnë të plota tarifat e tyre të studimit.

Ndërkohë dy sektorët e goditur më rëndë nga pandemia, industria fason dhe sektori i hotelerisë dhe turizmit, nuk kanë rezultuar sektorët më të financuar nga ky instrument borxhi. Fasoneria rezulton numerikisht më e interesuara për ndihmë qeveritare me 44 kompani të përzgjedhura të cilat së bashku kanë përfituar 642 milionë lekë financim nga bankat, dhe për shkak të nevojave të tyre për likuiditet ato kanë tërhequr mbi 70% të shumës deri në fund të muajit maj. Ndërsa nga sektori i hotelerisë dhe turizmit, vetëm 5 kompani janë bërë pjesë e skemës së kredive me një vlerë minimale prej 18.4 milionë lekë në total.



Ndërkohë që disa kompani koncensionare përfitojnë shuma të mëdha kredish me zero interes, edhe pse dukshëm nuk kanë pasur nevoja emergjente për likuiditet, për aq kohë sa nuk i kanë tërhequr këto para nga llogaritë e tyre, sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nga muaji **shkurt deri në korrik të vitit 2020, janë mbyllur 32.400 biznese**, 98% e të cilave ishin biznese të vogla. Nga mbyllja e këtyre bizneseve kanë mbetur pa punë 57 mije persona.³

³ Burimi: Monitor.al <https://www.monitor.al/pasojat-e-krizes-mbyllen-32-4-mije-biznese-dali-te-papune-57-mije-persona-goditja-me-e-for-te-vegilit/>



Deficiti buxhetor dhe borxhi publik

Situata e rëndë ekonomike e shkaktuar si pasojë e Covid 19 ka sjellë një deficit buxhetor prej 38.5 miliardë lekësh vetëm për gjysmën e parë të vitit, i vlerësuar në rreth 4.9% të PBB-së. Në tremujorët e mbetur të vitit pritet një zgjerim i mëtejshëm i deficitit buxhetor, deri në 133 miliardë lekë, i nxitur në një masë të lartë prej shpenzimeve të mëdha publike.⁴ Rritja e shpenzimeve planifikohet të jetë e përqendruar kryesisht në investimet publike, duke kthyer shpenzimet publike në levën kryesore të formimit të kapitalit për gjysmën e dytë të vitit.

Për të përballuar këtë deficit, qeveria në qershor 2020 hyri në tregjet ndërkombëtare dhe emetoi një Eurobond 7 vjeçar me vlerë 650 milionë euro. Por zgjerimi i huamarrjes nga jashtë në një masë më të madhe se deficit i krijuar gjatë kësaj periudhe kohore, ka sjellë një tepricë likuiditeti në monedhë të huaj, me të cilën qeveria synon të rritë investimet publike për të kompensuar mungesën e investimeve private. Situata e përkeqësuar e ekonomisë globale, niveli i lartë i pasigurisë dhe rënia e kërkesës konsumatore, kanë ndikuar negativisht në vendimet e bizneseve për të kryer investime të reja. Pas rënies me 10.7% në tremujorin e katërt të vitit 2019, investimet totale në ekonomi thelluan rënien në 16.7% në tremujorin e parë të këtij viti. Rritja e pasigurisë lidhur me tërmetin dhe pandeminë ndikuan në aktivitetin investues privat, ndërsa investimet publike dhanë një kontribut të ulët pozitiv. Vlera e shtuar në ndërtim ra me 16.7% në tremujorin e parë dhe importi i mallrave kapitale u zvogëlua me 19%, në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë. Paralelisht me to, edhe rënia e investimeve në gazsjellësin TAP ka dhënë një ndikim të konsiderueshëm në nivelin e investimeve.

Përveç huamarrjes në tregjet ndërkombëtare, është rritur edhe huamarrja në tregjet e brendshme. Ndryshe nga vitet e tjera, në financimin e deficitit, instrumentet afatshkurtra dominuan kundrejt atyre afatgjata. Shtesa në lekë e huamarrjes në bono thesari për tremujorin e dytë ishte 8.9 miliardë lekë, ndërkohë që në obligacione ishte rreth 5 miliardë lekë. Gjithashtu në prill të këtij viti u emetua një obligacion i ri dy vjeçar me një vlerë prej 12.4 miliardë euro. Situata e rënduar gjatë periudhës së pandemisë, kërkoi edhe mobilizimin e instrumenteve jokonvencionale në financimin e deficitit, krahas atyre tradicionale. I tillë ishte dhe instrumenti i financimit të shpejtë, Rapid Financing Instrument (RFI), i mundësuar prej FMN-së, në shumën e rreth 22.2 miliardë lekëve (ose 174 milionë euro)⁵.

⁴ Banka e Shqipërisë, Raporti tre mujor i politikës monetare 2020/III file:///C:/Users/use/Downloads/RPM_2020_III_shqip_17431%20(2).pdf

⁵ Burimi: Monitor.al "FMN: Paketat e ndihmës të shkijnë tek nevojtarët, duhet transparencë. Jemi gati për një marrëveshje me Shqipërinë" <https://www.monitor.al/fmn-paketat-e-ndihmes-te-shkojne-te-nevojtares-duhet-transparence-jemi-gati-per-marreveshje-me-shqiperine/>

Për gjysmën e parë të vitit, të ardhurat rezultuan rreth 195 miliardë lekë, me një rënie të ndjeshme vjetore prej 13.8%. Rënia e të ardhurave u diktua veçanërisht prej atyre me karakter tatimor. Përkeqësimi i tyre në gjysmën e parë të vitit 2020 reflekton rënien e konsumit privat, pezullimin e pjeshëm të aktivitetit ekonomik në vend, si edhe lehtësirat fiskale të marra për mbështetjen e bizneseve të prekura prej Covid-19.



Krahasimi i paketave financiare të Shqipërisë me Rajonin


Fondi Monetar Ndërkombëtar analizoi paketat e ndihmës për secilën nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Megjithëse instrumentet e përdorura janë të ngjashme dhe përfshijnë programe të subvencionimit të interesave të kredive, shtyrje të afatit të pagesave të taksave dhe kredive ose subvencionim i pagave për bizneset e prekura, **rezulton se Shqipëria ka pasur ndihmën direkte më të ulët në rajon, me vetëm 0.86%** e PBB, konkretisht 97 milionë Euro ndihmë të drejtpërdrejtë tek qytetarët dhe bizneset. Përgjithësisht **vendet e rajonit pjesën e ndihmës direkte që shkoi drejtpërdrejt në llogaritë e qytetarëve e kishin më të madhe se mbështetjen indirekte** që përfshinte shtyrje taksash dhe garancinë sovrane.

Paketa shqiptare anti-COVID ofroi mbështetje të kufizuar me fonde të drejtpërdrejta, duke qenë se vendi ynë ka rendimet të ulët fiskal në raport me vendet e tjera dhe një nivel më të lartë borxhi. Grumbullimi i të ardhurave buxhetore në rreth 27% të PBB dhe një borxh publik më i lartë se 65% e PBB-së para krizës, nuk i krijojnë hapësira për mbështetje direkte qeverisë shqiptare në raport me rajonin.⁶

Shqipëria ka ndihmën më të ulët direkte në rajon

Ndihma të drejtpërdrejta tek qytetarët dhe bizneset (%) ndaj PBB

Burimi: FMN



⁶Monitor.al “Paketat anti covid, borxhi i lartë e le Shqipërinë të fundit në rajon për mbështetjen direkte”
<https://www.monitor.al/paketat-anti-covid-borxhi-i-larte-e-le-shqiperine-te-fundit-ne-rajon-per-mbeshtetjen-direkte/>

Banka Botërore analizoi se, ndërkohë që të gjitha vendet kanë adoptuar masa për menaxhimin e krizës me qëllim zbutjen e efekteve të kërkesës mbi të ardhurat dhe falimentimin e firmave, vende si Serbia, të cilat kanë më shumë amortizatorë fiskalë, kanë mundur të financojnë programe më të mëdha mbështetëse. Që prej shpërthimit të Covid-19, shumë vende, përfshirë Ballkanin Perëndimor, kanë shpallur gjendjen e jashtëzakonshme. Ndërsa Mali i Zi dhe Shqipëria ishin dy shtetet me borxhin më të lartë në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto, përkatësisht 79% dhe 66% të PBB-së dhe kjo kufizoi hapësirat e tyre për politikë nxitëse fiskale.

Në fillim të muajit gusht, Standard & Poor's (S&P) konfirmoi vlerësimin aktual në "B+" për Shqipërinë, si dhe një perspektivë "të qëndrueshme". Por, agjencia paralajmëron se do të mund ta ulë renditjen vitin e ardhshëm, nëse borxhi publik vazhdon rritjen dhe materializohen detyrimet e PPP-ve. Po ashtu sipas kësaj agjencie borxhi publik ka arritur shifrën rekord prej 80% të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe pritet që deficitin të rritet në 8,5% të PBB-së këtë vit, për shkak të humbjeve në të ardhura, shpenzimeve shtesë që lidhen me pandeminë, dhe shpenzimeve të larta të kapitalit. Agjencia vlerëson ekspozimin ndaj rreziqeve të mundshme fiskale, në formën e partneriteteve publike private (PPP) dhe nevojën për parashikueshmërinë e tyre. Ajo shprehet se autoritetet po ndjekin në mënyrë aktive përpjekjet për të përmirësuar profilin e borxhit publik, i cili aktualisht karakterizohet nga risku i rifinancimit dhe ai i kursit të këmbimit ⁷.



Megjithëse ekonomia jonë po përballlet me një nivel rekord të borxhit publik dhe deficitit buxhetor, duket se tërmeti dhe pandemia nuk janë të vetmet shqetësime. Në datë 23 mars investitori i njohur italian, Francesco Becheti fitoi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Washington gjyqin ndaj shtetit shqiptar, i cili duhet t'i paguajë një dëmshpërblim të majmë prej 110 milionë eurosh biznesmenit në fjalë, gjë që pritet të rëndojë akoma më shumë financat tona publike.

⁷ Burimi: Standard&Poor's

<https://www.spglobal.com/ratings/en/research-insights/topics/coronavirus-special-report>



Tërmeti dhe procesi i rindërtimit.

Në 26 Nëntor 2019 Shqipëria humbi 51 jetë njerëzish nga tërmeti, ndërsa 913 të tjerë u plagosën. Bilanci i dëmeve të shkaktuara ishte po aq i rëndë, rreth 200 mijë shqiptarë nga 11 bashki të vendit u prekën, ku **95 mijë banesa u deklaruan të dëmtuara, 11 mijë prej të cilave u shpallën më vonë të pabanueshme.**

Një ditë pas tërmetit të 26 nëntorit kryeministri Rama premtoi se të prekurit nga kjo fatkeqësi do hynin në shtëpitë e reja brenda vitit 2020. Në vijim të zotimeve ai madje garantoi se banesat e para individuale do ishin gati brenda 6 mujorit të parë të këtij viti, por megjithëse tashmë kanë mbetur vetëm 4 muaj deri në përfundim të këtij viti, keto banesa individuale nuk janë ndërtuar.

Në shkurt 2020, qeveria përlogariti se **fatura e dëmeve nga tërmeti ishte rreth 985 milionë euro, ndërkohë që i gjithë procesi i rindërtimit do të kushtonte rreth 1.08 miliardë euro.** Me këtë faturë financiare, kryeministri Edi Rama iu drejtua konferencës së donatorëve dhe mori që andej premtime për 1.15 miliardë euro në donacione dhe kredi bankare. Në datën 29 shkurt Ministri i Rindërtimit Arben Ahmetaj në një dalje publike tha se *“Brenda vitit 2020 ndërtojmë 4 mijë banesa individuale. Puna ka filluar dhe javë që vjen Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) dhe Bashkia Tiranë, dalin në një prokurim ndërkombëtar për njësitë individuale dhe brenda vitit 2020 të gjithë familjet që kanë humbur shtëpitë individuale do të festojnë vitin e ri në shtëpitë e reja, të modeleve bashkëkohore”.*

Megjithëse kryeministri Rama vazhdimisht ka deklaruar se ky proces është ngadalësuar për shkak të pandemisë, e vërteta është që procesi i rindërtimit shënoi zvarritje e vonesa të njëpasnjëshme ende pa nisur pandemia. Më 10 mars nuk ishte shpallur ende gara ndërkombëtare për kompanitë që do ndërtonin banesat individuale.



Në datën 18 korrik Qëndresa Qytetare i ka dërguar Ministrisë së Shtetit për Rindërtim një kërkesë për informacion, ku kërkojmë të dimë se se ç'pjesë e donacioneve të premtuara në Konferencën e Donatorëve të datës 17 shkurt janë disbursuar aktualisht për llogari të shtetit shqiptar. Përgjigjia e ministrisë ishte se **“Vlera e donacioneve të disbursuara aktualisht për llogari të shtetit shqiptar është 3 (tre) milionë lekë drejtpërdrejtë të disbursuara në Thesar, dhe rreth 270 milionë euro është vlera e projekteve që po zbatohen nga vetë donatorët në sektorin e strehimit, edukimit, infrastrukturës, trashëgimisë kulturore etj”**

Pra aktualisht nuk janë përthithur as 25% të donacioneve të premtuara në konferencën e donatorëve, pasi grantet janë shuma të dhuruara kundrejt nje projekti dhe mesa duket shteti shqiptar nuk i ka gati projektet për t'ia u paraqitur donatorëve për financim. Duke parë pamundësinë e shtetit shqiptar për t'i përthithur këto donacione, në rishikimin e fundit të buxhetit të bërë në 29 Korrik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka buxhetuar 14 miliardë lekë shtesë në fondin e rindërtimit. Gjithashtu shihet që donatorët kanë mungesë besimi në menaxhimin të fondeve nga qeveria e Shqipërisë pasi vetem 3 milionë lekë janë disbursuar drejtpërdrejt në thesar, ndërsa pjesa tjetër kanë preferuar t'i zbatojnë vetë këto projekte.

Ndërkohë që lidhur me ecurinë e punës në kantiere, Ministria e Shtetit për Rindërtim u përgjigj se: “Deri në fund të muajit korrik ka filluar puna në 33 kantiere të objekteve arsimore dhe në 4 kantiere të infrastrukturës publike nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Bashkia Tiranë si njësi zbatuese është duke ndërtuar 48 banesat e para individuale në Farkë dhe ka lidhur kontrata për 199 banesa individuale në total.”

Mesa duket ky proces është duke ecur me ritmet të ngadalta dhe familjet e mbetura të pastreha si pasojë e tërëmrut, pavarësisht premtimeve duhet të bëhen gati ta kalojnë edhe një dimër tjetër në çadra.



Gjetjet Kryesore



Buxheti i shtetit është rishikuar **3 herë** brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore dhe pritet një **reduktim në masën 63.1 miliardë lekë** i të ardhurave buxhetore në krahasim me buxhetin fillestar të vitit 2020.



Banka Botërore, parashikojnë një **tkurrje nga 5 deri në 6.9% të ekonomisë, e cila llogaritet më e larta në rajon.**



Nga paketa e dytë financiare kanë përfituar **167.206 punonjës, 10 mijë më pak nga sa kishte deklaruar kryeministri gjatë prezantimit të paketës.**



Nga fondi i dytë i Garancisë Sovrane kanë përfituar **119 biznese me një vlerë afërsisht 3.1 miliardë lekë, nga 15 miliardë lekë që ishin vënë në dispozicion me anë të këtij instrumenti**



Gjysma e Fondit të Garancisë Sovrane shkoi për llogari të **10 kompanive të mëdha, njëkohësisht përfituese të koncesioneve**, të cilat së bashku deri në fund të muajit maj **kishin tërhequr nga llogaritë vetëm 24% të shumës totale të përfituar**, duke mos reflektuar nevojë emergjente për likuiditet.



Fasoneria rezulton numerikisht më e interesuara për ndihmë qeveritare me **44 kompani përfituese të cilat së bashku kanë përfituar 642 milionë lekë** financim nga bankat, dhe për shkak të nevojave të tyre për likuiditet ato kanë **tërhequr mbi 70% të shumës** deri në fund të muajit maj.



Nga muaji **shkurt deri në korrik të vitit 2020, janë mbyllur 32.400 biznese, 98% e të cilave ishin biznese të vogla.** Nga mbyllja e këtyre bizneseve **kanë mbetur pa punë 57 mijë persona.**



Gjashtë shkolla dhe universitete private janë miratuar për të përfituar kredi me **zero interes me një vlerë totale prej 163.2 milionë lekësh** të përfituara, ndërkohë që **universitetet publike nuk marrën asnjë mbështetje shtesë** dhe pavarësisht kërkesave të përsëritura të studentëve, u detyruan të paguain të plotë tarifat e studimit.



Shqipëria ka pasur **ndihmën direkte më të ulët në rajon, me vetëm 0.86% e PBB,** vetëm 97 milionë euro ndihmë të drejtëpërdrejtë tek qytetarët dhe bizneset.



Borxhi publik ka arritur shifrën rekord prej 80% të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe pritet që deficitin të rritet në 8,5% të PBB-së këtë vit.



Ne mungese të projekteve qeveria nuk ka mundur të përthithur **as 25% të donacioneve të premtuara në konferencën e donatorëve**, për tu perballur me këte mungese fondesh, në 29 korrik Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka buxhetuar **14 miliardë lekë shtesë në fondin e rindërtimit nga buxheti i shtetit.**

Rekomandime

Vendi ynë nuk e pati të thjeshtë përballimin e izolimit, pasi ne nuk ofrojmë shumë produkte virtuale të mbështetura në teknologjinë e informacionit. Për këtë arsye, një mbyllje e dytë e ekonomisë si rezultat i përkeqësimit të gjendjes së pandemisë do të ishte fatale. **Rritja e automatizimit dhe informatizimit të ekonomisë, që është ende në nivele shumë të ulëta, duhet të jetë prioriteti i kësaj dekade.**



Që nga muaji mars i këtij viti afersisht 3,000 biznese kanë falimentuar, ndërkohë që mbështetjen financiare nga qeveria kryesisht e marrin ato biznese që prej vitesh vjelin para nga taksapaguesit shqiptarë nëpërmjet kontratave koncensionare. **Fjala kryesore e politikave të rimëkëmbjes duhet të jetë likuiditeti. Qeveria duhet të vendosë fokusin në shmangien e falimentimit të biznesve të mesme dhe të vogla. Mbështetja financiare duhet të jetë transparente dhe masive, dhe bizneset të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa privilegjuar askënd.**



Duhet trajtuar dhe menaxhuar me kujdes deficit buxhetor dhe borxhi publik, i cili ka arritur shifrën rekord prej 80%. Jemi ende në një situatë të panjohur mbi vazhdimësinë e pandemisë, ndaj edhe shpenzimet publike duhet të shihen me kujdes. **Nevojitet një shkurtrim drastik i shpenzimeve operative si në nivel vendor, po ashtu edhe në nivel qendror.**



Edhe agjensia ndërkombëtare **Standard & Poor's** në vlerësimin e saj të fundit për Shqipërinë **vlerëson riskun që mund të vijë nga zbatimi i kontratave të formës PPP në vazhdim**, prandaj do ishte i nevojshëm një pezullimi afatmesëm (2-3 vite) i kontratave koncensionare PPP që nuk kanë filluar nga zbatimi dhe rishikim i kontratave koncensionare të atyre partneriteteve që janë në proces. Shteti duhet menjëherë të bëjë kontrolle dhe auditime të tyre dhe të merren masa duke u bazuar në shkeljet e gjetura, si dhe rekomandimet e vazhdueshme të KLSH.



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.



www.qeverisja.qq.com.al

RAPORT MONITORIMI
FINANCAT & EKONOMIA
Maj-Korrik 2020